

**VENDIM**  
**I ASAMBLESE TE PERGJITHSHME**  
**TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**“EMS Western Balkan” SHPK**  
**Vendim Nr. 1**

Sot, me datë 11 / 10/2023, ora 10:00, në Selinë e Shoqërisë, në adresën Rruga “Ibrahim Rugova”, ndërtesa 42, hyrje nr.7, kati i 5, Tiranë, Shqipëri, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë EMS Western Balkan Shpk, e thërritur nga Administratori i Shoqërisë në përputhje me parashikimet ligjore dhe konform Statutit, për të diskutuar dhe vodosur mbi rendin e ditës.

Janë të pranishëm Administratori i Shoqërisë Znj. Enkeleda Kuka dhe Ortaku i Vetëm i saj:

- Ortaku i Vetëm: **Shoqëria Mantic Shpk**, zotërues me 100% kuota të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori i saj, **Z. Genti Daci**.

Merr kryesinë e mbledhjes, Znj. Enkeleda Kuka njëherësh edhe mbajtëse e procesverbalit, e cila e deklaron mbledhjen të hapur. Pasi shpreh aftësinë dhe vullnetin e Ortakut të vetëm për të vendosur mbi rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për mbledhje, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve të mbledhur rregullisht në përputhje me paragrafin e dytë të Nenit 83 të Ligjit nr 9901/ 2008 “Për tregtaret dhe shoqerite tregtare”, dhe të aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur me rendin e ditës si më poshtë vijon:

- *Zmadhim të kapitalit themeltar të Shoqërisë EMS Western Balkan Shpk, me anë të shtimit të kontributit fillestar në para, në vlerën 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro, e konvertuar në monedhën Lekë me referencë kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e këtij Vendimi, e barabartë në shumën 15,844,500 (pesëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind) Lekë.*

Pas diskutimit të cështjeve në rendin e ditës, Asambleja e Ortakëve miraton vendimin e mëposhtëm:

**VENDIM**

1. *Miraton zmadhim e kapitalit themeltar të Shoqërisë “EMS Western Balkan” sh.p.k, me anë të shtimit të kontributit fillestar në para, në vlerën 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro, e konvertuar në monedhën Lekë me referencë kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e këtij Vendimi, e barabartë në shumën 15,844,500 (pesëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind) Lekë.*
2. *Kapitali i përgjithshëm themeltar i Shoqërisë “EMS Western Balkan” sh.p.k nga vlera 100,000 (njëqind mijë) Lekë do të bëhet 15,944,500 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind) Lekë në total dhe vlera nominale e kuotës së Ortakut do të rritet përkatësisht sipas pjesëmarrjes që zotëron në kapitalin e Shoqërisë, vlera nominale e kuotës do të bëhet si më poshtë:*
  - *Ortaku Mantic Shpk zotëron 1 kuotë ekuivalente në masën 15,944,500 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind), që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë*



3. Kontributi fillesttar shtesë në para i Ortakut të vetëm të Shoqërisë "EMS Western Balkan" sh.p.k për zmadhimin e kapitalit themeltar do të shlyhet me këste brenda një afati 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit të këtij Vendimi, në përputhje me parashikimet ligjore neni 113 dhe neni 168 e në vijim të ligjit për Shoqëritë tregtare dhe Statutit të Shoqërisë.
4. Të miratojë pasqyrimin e ndryshimeve edhe në nenin përkatës Kapitali Themeltar të Statutit të Shoqërisë "EMS Western Balkan" sh.p.k në përputhje me parashikimet ligjore neni 68, pika 5 të ligjit për Shoqëritë tregtare,
5. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për të bërë regjistrimin e këtij vendimi pranë QKB sipas rregullave në fuqi, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të tij kundrejt personave të tjera për këtë qëllim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë në datën e nënshkrimit.

Duke mos patur cështje të tjera për të diskutuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, mbledhja u deklarua e mbyllur.

Për sa u diskutua në mbledhje u mbajt ky process-verbal në 2 (dy) kopje, i cili nënshkruhet nga Ortaku i vetëm dhe pjesëmarrësit, pasi ai u lexua me zë të lartë.

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE TE SHOQERISE  
" EMS Western Balkan " SHPK**

**Kryetari**

Znj. Enkeleda Kuka



**ORTAKU I VETEM**

Z. Genti Daci

